



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV-SË NR.3470,
BASHKIA URA VAJGURE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË
DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI -	Anëtar
Edlira	JORGAQI -	Anëtare
Rezarta	BITRI -	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së qv-së nr.3470, Bashkia Ura Vajgurore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë Ura Vajgurore, me shkresën nr. 12995, datë 29.06.2019, kërkon dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr.3470, duke e propozuar me vendndodhje në Ambulancë.

Duke vlerësuar propozimin për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së, , paraqitet projekt akti për shqyrtim dhe miratim të KQZ-së.



Nr. 933 i Vendimit

Data 29.06.2019

Ora 18:00 e Vendimit

Për projektvendimin "për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së qv-së nr.3470, Bashkia Ura Vajgurore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", nenin 21, pika 3, nenin 62, pika 4 dhe 11, neni 93, pika 2, gërma "a", të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr.3470, duke e caktuar në Ambulancë Bashkia Ura Vajguore.
2. Kryetari i Bashkisë të publikojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

